

Nr. 01-438
Data: 12.09.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z/Znj.

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e pestë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më 13.09.2018 (e enjte) duke filluar në orën 10:00.

R e n d i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raport nga Drejtoria e Inspeksionit për problemet në Komunën e Novobërdës;
3. Rruga Stanishor-Strazh;
4. Të ndryshme;

Me: 09.09.2018
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËBE - IZLAZNA

Nr. 01-439
Mojimi 12.09.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo-Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 13.07.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Abdyl Gashi, Dobrivoje Djordjovic, Behare Jashari, Aleksander Pavic, Zv.Kryesuesi i Kuvendit për Komunitete Bajrush Ymeri, Drejtori i shendetësisë Tomislav Stankovic, Zyrtari për Sherbime Publike Bajram Abazi dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshtendetë të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raport nga Drejtoria e shendetësisë dhe mirqenjes sociale rrëth gjendjes në ambulantat e në veqanti QKMF-së në Novobërdë dhe asaj në Llabjanë;
3. Problemi i transportit publik në Komunen e Novobërdës;
4. Asfaltimi i rrugës në fshtin Bostan;
5. Problemet me ujra të zeza në fshtatin Bostan;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend ditë?

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua njëzëri nga anëtarët prezent të Komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbale u aprovua njëzëri nga anëtarët prezent të Komitetit.

Pika e dytë: Raport nga Drejtoria e shendetësisë dhe mirqenjes sociale rrëth gjendjes në ambulantat e në veqanti QKMF-së në Novobërdë dhe asaj në Llabjanë;

Shpresa Kqiku për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të shendetësisë Tomislav Stankovic.

Tomislav Stankovic pasi përshtendetë të pranishmit tha: me material e keni marrë reportin, jam munduar të ju informoj se ku është problemi e në veqanti QKMF në Novobërdë dhe Llabjan që janë përmendur në rend të ditës dhe problemi kryesor për mungesë të materialeve në këto qendra dhe në qendra tjera është mungesa e buxhetit. Duke pasur paraysh që ambulantat në fshtatin Carevc, Bolevc janë në një distanc të madhe e kemi marrë një petition nga ata qytetar për hapjen e një ambulante në at vendbanim dhe të gjithë e dim se buxheti i Komunës është jashtëzakonisht shumë i ulët jo vetem në Drejtorin e Shendetësisë por në të gjitha sektoret, duke pasur parasysh buxhetin dhe duke pasur paraysh se nese fillojm me furnizimin në të gjitha ambulantat egzistuese më këtë buxheti që do të kemi

problem, mirëpo siç e kam permendur edhe në raport ne dje kemi filluar me procedurat për sigurimin e mjeteve të nevojshme medicionale për të gjitha këto ambulanta duke kyçur edhe ambulantën e re në fshatin Bolevc, e kam para jush dokumentin i cili tregon se i kemi siguruar mjetet dhe do të fillojn procedurat tjera dhe deri në fund do të furnizohen ambulantat me materiale, pra do të thotë se nuk ka pasur asnjë problem tjeter përvèç problemit financiar, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi përshtendetë të pranishmit tha: kerkoj që të dihet se sa është shuma që ndahet për ambulanta dhe cila është kërkesa e tyre dhe pyetja tjetër është se prej ku janë marrë donacionet apo investime për këtë ambulant të re perderisa ambulantat egzistuese po kanë vështërsi me materiale.

Tomislav Stankovic tha: sa i përket ambulantave ne i pranojm të gjitha kërkesat prej QKMF në Novobërdë edhe pse i kemi edhe 8 sherbime tjera në teritorin e Komunës tonë, sigurisht jeni të njoftuar për egzistimin e sistemit paralel të funksionimit në Arsim dhe Shendetësi në Komunën tonë, ne kemi obligime ligjore ndaj të gjitha objekteve shendetësore mirëpo në një mënyrë shumë po na lehteson punën edhe ky sistemi paralel, qështja e funksionimit të këtyre ambulanateve nuk është qështje e jona Komunale por e nivelit Qendror dhe në anën tjetër kemi arritur që ti harmonizojm gjérat në mënyr që mos të dyfishohen kërkesat dhe kemi arritur një gjuhë të përbashkët që këto ambulanta të furnizohen mirë, sa i përket pyetjes së dytë Drejtori i QKMF i dërgon kërkesat tek ne dhe në zyre të prokurimit, zyra e prokurimit i fillon procedurat dhe i funzion më materiale me aq mjete sa i lejon Kryetari i Komunës ndërsa sa i përket ambulantes në Bolevc aj objekt ka egzistuar edhe më herët dhe me një vlerë të mjeteve rrëth 900€ ne do ta funksionalizojm at objekt egzistues.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshtendetë të pranishmit tha: po ndërlidhem me diskutimin tuaj pasi që e permendet sistemin paralel por tju informoj se as në Kufc, Koretishtë, Stanishor nuk mund të merrni asnjë shërbim pasi që këto ambulanta nuk kan mjete, sigurisht që ju nuk jeni fajtor për këtë. Fillimisht që të duhej të funksionoj një ambulant duhet të ketë një mjek dhe sa kam unë informata Institucionet e Kosovës nuk kan lejuar që të punësohet ndonjë mjek në ato ambulanta, ndërsa në anën tjetër të punësuarit në këto ambulanta që ju i përmendet nga institucionet e Kosovës hasin në pengesa nga puntorët e Ministrisë së Shendetësisë së Serbisë. Po më vjen mirë që po hapni ambulanta të reja pasi që është e nevojshme për ata banorë mirëpo kishe qenë mirë që të hapet një konkurës për pranim të disa mjekve që të punojn, pasi që kemi shumë të rinjë të diplomuar në Komunën tonë në drejtim të mjekësisë dhe pyetja tjetër është sa i përket Qeverisë së Kosovës sa kam unë informata nuk financon për sigurim të barnave dhe mjeteve tjera medicionale në zonat ku jeton Komuniteti Serb.

Tomislav Stankovic tha: sa i përket punësimit të mjekve të rinjë besoj që të gjithë e keni buxhetin e Komunës i cili është transparent dhe aty mundë të shihni planifikimet përmallra dhe shërbime për të punësuarit e rinjë për të gjitha funksionimet e shendetësisë dhe e shikoni se nuk ka mundësi për punësim të asnjë puntori dhe jo më shumë, unë pajtohem me këtë problem, tju informoj se në mandatin e mëhershëm janë punësuar tre puntorë të rinjë dhe për ata puntor asnjëher Institucionet Komunale nuk kan mundur të sigurojnë paga, humaniteti i kolegve kan ndar menditje nga pagat e veta për ti mbuluar këta të tre të punësuar dhe deri vitin e kaluar kemi pasur probleme në Gjykatë për këta të punësuar. Mos të përsëris por Buxheti Komunal është transparent e keni dëgjuar edhe në Kuvend pasi që jeni antarë edhe të Kuvendit e keni parë se nuk ka mundësi punësimi të një punëtori të ri shtesë e jo më shumë. Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare që egzistojnë në Komunën tonë e kan qendren kryesore familjare që eshtë në Novobërdë dhe kjo qender kryesore e bënë kërkesen për të gjitha qendrat tjera as sa i kemi mundësi i furnizojm, gjithashtu edhe Ministria kur ka mundësi na ndihmon. Në kemi pak mjete aq pak sa nuk mundemi ti mbulojm nevojat vetem në qendër kryesore, sikur mos të ishte kjo gjendje financiare ne nuk do të ishim këtu për të diskutuar, sa i përket asaj që përmendet ju se ka revolt mes të punësuarve Serb dhe Shqiptarë ka pasur më herët por tanë nuk egzistojn këto probleme.

Zv.Kryesuesi i Kuvendit Bajrush Ymeri pasi përshendetë të pranishmit tha: ju e dini që janë katër mekanizma që bëjnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetve, është Nënkyetari për Komunitete, zv.Kryesuesi për Komunitete, Shefja e Zyres Komunale për Kthim dhe Komiteti për Komunitete, duke e pasur parasysh këtë ne duhet ta ndihmojm Kryesuesen e komiteti për pregaditje të rendit të ditës, ka qenë kërkesë e imja për këtë pikë të rendit të ditës pasi që ka pasur kërkesa edhe në Kuvend dhe pse e kemi bërë kështu këtë pikë në rend të ditës është për arsy se kemi pasur kërkesa direkt nga stafi udhëheqës i këtyre dy ambulantav për këtë gjendje të mjerueshme dhe a jemi ne për këtë gjendje të mjerueshme?, nuk jemi për arsy se shendetësia e ka një fond të vetin, gjithashtu edhe Komuna mund të ndaj një fond të posaqëm për sherbime komunale, për funksionim të ambulantave ashtu si duhet të funksionojn. Është tmerr pasi që doktori nuk ka as recept për ti përshkruar barnat pacientave, ndoshta kjo gjendje është edhe në ambulanta tjera por nuk kemi pasur ndonjë kërkesë të veçant. Ne jemi në një gjendje të vëshirë pasi që na është bërë dëmi më i madh me procesin e decentralizimit, ne kemi qenë dhe jemi qytetarë të përgjegjëshëm, qytetarë të dëgjueshëm, jemi Komuna më e qetë në Kosovë, asnjë problem nuk ka ndodh i natyrave të mëdha që ndodhin në Komunat tjera, të gjithë këtë dëm e kemi pranuar në qetësi për hirë të situatës, sa problemet i kemi me hajni policia nuk kan as automjete, sa problemie i kemi me zjarre e ne i kemi vetëm 8 zgjarrëfiks gjithashtu sa probleme me shendetësi e ne kemi pak mjek e të gjitha këto probleme qëndrojn për arsy se jemi territor shumë i shperndar e kemi pak banorë dhe e di që ka kritere e që për neve janë të dëmshme p.sh numri i mjekve në territor të komunës përcaktohet në bazë të numrit të banorëve, askujt nuk po i intereson që territori i Komunës është kaq i shperndarë dhe nuk ka mundësi me u mbulu, nese ne kërkojm me u rrit stafi në ambulanta me mjek dhe teknik atëher ne duhet ti mbulojm prej të hyrave tona vetanake, pra kjo teknikishtë është e pamundur andaj ne perqendrohem i të bëjmë diçka aty ku kemi mundësi, këto ambulanta që i kemi ti mbajm si duhet. Sa i përket ambulantes në Bolevc është ndërtuar më kërkesen time sa kam qenë unë Kryetar, unë e kam vizituar fshatin Bolevc dhe e kam parë se shkolla dhe ambulanta kan qenë në gjendje të mjerueshme dhe e kemi ndërtuar një objekt të ri me qëllim që shpejt të funksionalizohet por nuk ka pasur mundësi më herët, pra unë e kisha lut Drejtorin që të bëj një vizit në të gjitha ambulantat pasi nuk janë shumë dhe nga afër të njihet me gjendjen që kan dhe për secilen ambulant të merr me shkrim të kalkuloj shumën e nevojshme dhe të kërkoj prej neve një mbështetje ne Kuvend dhe në Komitet dhe të kërkoj edhe prej Kryetarit të Komunës që ato kërkesa të shtyhen përpëra.

Dobrivoje Djordjevic tha: i nderuar zt.Drejtor mos e merrni këtë qështjen time si personale ndaj jush por përséri po e them dhe po pyes si është e mundur që në ambulantat ku është Komuniteti Serb me shumicë mos të ketë mjete dhe së paku të punësohet 1 ose 2 mjek të Komunitetit Serb kur e dim se motrat që jan të punësuar aty dhe stafi teknikë e kryejn rolin e depoistit, ato mundë të ofrojn një ndihmë por në mënyrë ilegale në mungesë të mjekut, gjithashtu ta përmendi se prej vitit 2017 ne vitin 2018 i kemi bartur 45.000€ si mund të deklaroheni se skeni mjete, në anën tjetër vendbanimi Koretisht dhe Kufc janë fshatrat më të mëdha dhe nuk e dim se kur ka mjek, tanë po hapet ambulanta në Bolevc por çka vlen ambulanta pa mjek.

Tomislav Stankovic tha: sa i përket punësimit të mjekve unë sa herë e përgadis buxhetin për vitin e ardhshëm gjithmonë e paraqes edhe kërkesën për katër vende të punës për katër puntorë por asnjëher nuk është aporovuar nga Ministria e Financave gjithashtu e përmendi edhe zv.Kryesuesi se me këtë buxhet është e pamundur të punësohet një mjek, po e permendi edhe njëher pasi që edhe ju e keni parë buxhetin dhe ne nuk kemi mjete për punësimë të reja. Pasi që e permendes se çfarë vlere ka ambulanta në Bolevc pa mjek po ju tregoj një rast nese nje pacient shkon në Kamenic, Gjilan ose Novobërdë kontroll mjeksore dhe mjeku ja përshkruan disa ineksione për të mos udhëtuar aj pacient çdo ditë majton ajo ambulant dhe aj staf për ti kryer këto shërbime.

Abdyl Gashi tha: mendoj që Komuna si Komunë funksionon në bazë të dy digastereve kryesore e që janë arsimi dhe shendetësia, funksionimi i qeverisjes lokale është afër këtyre dy digastereve të cilat i shërbejn dhe janë afër qytetarëve, e kam parë një rast në Llabjan ku një pacient ka kërkuar një pastrim të plagës dhe nuk ka pasur fashë, jod e as formular për pranim të pacientave. Në këtë shekull mos me egzistu gjërat elementare përdersia në Komunat tjera bëhen kontrolla sistematike në shkolla, sikur të bëheshin këto kontrolla në Komunën tonë do vërejshim se 20-30% e nxenesve ndoshta kan probleme me shikim dhe kjo krijon vështësi edhe në mësim dhe kjo është mirë të praktikohet pasi ka motra medicionale dhe nuk kan numer të madh të pacientave. Ne të gjitha mbledhjet i kam cek gjendjen e mjerueshme në ambulanta dhe kur ka qen plani punës i KAB kam kërkuar që ajo shumë prej 5.000€ ku në emër të punes kanë bërë plazh të detikohet për të gjitha ambulantat. Ne nuk jemi për tu ndar si etni por jemi për ti zgjedhur problemet bashkarishtë, jetojm në një Komunë ku buxheti ndahet në kokë banori dhe decentralizimi ka shkaktuar probleme të mëdhaja.

Tomislav Stankovic tha: e di që ka pasur situata që nuk ka pasur jod por siç ju njoftova deri në fund të muajit apo edhe më herët kjo qështje do të kryhet, e di situaten në të cilën gjendemi dhe po më vjen turp nga kjo, sa i përket kontrollave sistematike është qështje e Ministrisë dhe në Komunën tonë egziston vetem shendetësia primare dhe nuk kemi mjek specialista në fusha të ndryshme siç e permendet ju të pamurit, edhe po të deshironim ti realizonim këto kontrolla ne nuk kemi mjek. Sa i përket KAB dhe shkuarjes në Durrës nuk është qështje që kam mundur unë të vendosi, ndoshta kishte qenë mirë që ato mjete ti shpenzonim në shendetësi. Të gjithë ne po pajtohem që kur është bërë regjistrimi i popullësisë nuk është bërë si duhet dhe kjo po na shkakton vështësi. Në momentin që më është dorzuar detyra zt.Xhemjal Novobërdali më ka ndihmuar rrëth pregaditjes së një projekti për Qeverinë Japoneze ku vlera e projektit ka qenë rrëth 70.000 € kemi kërkuar një autoambulanc apo automjet shendetësor që të jetë një klinik levizese me të gjitha paisjet, arsyetimin e kemi bërë se jemi një Komunë rurale dhe distancimi prej një vendbanimi në tjetrin është e madhe, e kemi menduar që të kemi një automjet të tillë që një ditë të shkoj në një vendbanim një ditë në një tjetër dhe nuk do të kishim kaq shumë nevoj për këto objekte të ambulantave, edhe vet Qeveria Japoneze është habitur pasi ka qenë risi për të, si është e mundur që në një Komunë të funksionojn dy sigurime shendetësore, nuk e kemi fituar këtë projekt edhe pse e kemi përgaditur në mënyrë profesionale, në fund na është kërkuar lista e pagave të atyre dy sistemeve, ata nuk kan mundur të kuptojn se si ka mundësi të egzistoj një gjë e tillë edhe pse kjo ka ekzistuar prej '99 dhe ky ka qenë problemi kryesore pasi të tjerët nuk kan arritur të kuptojn se si funksionon ky sistem disa puntor të paguhen prej njerit sistem e disa të tjer nga tjetri sistem por punojn në objekt të njejtë.

Zv.Kryesuesi i Kuvendit Bajrush Ymeri tha: u diskuta teper po përseni nuk besoj që do të ketë ndonjë rezultat andaj kërkoj nga Drejtori që të informoj Kryetarin për gjendjen në të cilën gjendemi dhe ti prezantoj ndonjë strategji të re, a kemi mundësi prej të hyrave tona vetanake me finançu ndonjë mjek apo jo?, para se të fukosohemi në hapje të reja të ambulantave ti financojm dhe ti mbajm si duhet këto që i kemi. Pasi mbledhja është thirr me kohë pasi që kemi kërkuar që mbledhja e komitetit të thirrët para KPF dhe Kuvendit andaj po kërkoj prej Kryesueses së Komitetit që të kërkoj prej Kryesuesit të Kuvendit që të fus pikë të rendit të ditës me këto rekomandime, unë do ta ndihmoj Kryesuesen që me material ti shkojn Kuvendit këto rekomandime.

Pika e tretë: Problemi i transportit publik në Komunen e Novobërdës;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Zyrtarit për Sherbime Publike Bajram Abazi.

Bajram Abazi pasi përhendeti të pranishmit tha: sa i përket transportit publik e dini që ky problem është që një kohë të gjatë, tju informoj se problemi është për aryse të operatorëve të cilët kanë bërë ankesa, pasi që Ministria ka hap tenderin e ka përzgjedh Kompanin por operatorët tjerë kanë bërë ankesa dhe pasi që është bërë rivlersimi lënda është kthyer në OSHP.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Zv.Kryesuesi i Kuvendit Bajrush Ymeri tha: unë kam qënë inicatori i parë që kam filluar me këtë transport prej vitit 2008, e kam thënë vazhdimisht dhe do të vazhdoj ta them që transporti për Komunën e Novobërdës është projekt më i rëndësishëm, a e dini sa ka ndikuar transporti publik në integrim të qytetarëve, transportin e kan shfrytëzu të gjithë qytetarët e Komunës së Novobërdës së bashku Shqiptarë, Serb dhe Rom dhe për 6 vite ka funksionuar si duhet dhe pas përfundimit të mandatit tim kan filluar problemet dhe e dini si është gjendja, ajo që është më e rëndësishmja e kam thënë edhe me një debat kur kam biseduar në telefon me Ministrin Pal Lekaj ku më është premtuar që ky problem do të zgjidhet shpejt por fatkeqësisht kanë kaluar 1 muaj dhe nuk ka ndonjë zgjidhje.

Behare Jashari pasi përshtedetë tē pranishmit tha: kur kemi pasur një takim me D.SH.P ka thënë se nese nuk zgjidhet problemi i transportit komuna do të lëshoj në qarkullim një minibus brenda Komunës së Novobërdës ku do ta shfrytzonin nxënësit, penzionerët, të gjithë banorët mbrenda Komunës.

Zv.Kryesuesi i Kuvendit Bajrush Ymeri tha: për ta plotësuar Beharen, ne kemi marrë vendim në Kuvend Komunal me kërkesë tē Drejtoreshes me i nda disa mjete për blerjen e një minibusi që tē operoj brenda teritorit të Komunës, ajo duhet tē jep llogari se ku ka mbetur kjo punë pasi që i ka marrë mjetet në emer të minibusit për transport tē banorëve, kem me kërkua në cilën mbledhje është marrë ky vendim dhe do të kërkojm llogari se ku është.

Bajram Abazi tha: është marrë vendim për me u nda mjetet por unë nuk besoj që jan nda, sikur tē ishin nda këto mjete me siguri që do të blehej deri më tanë, sa i përket operatorëve ekonomik për tē pasur një vij tē re nuk kan llogari asnje Kompani. Problemi kryesor është operatori Merkatori i cili po na bënë probleme me ankesa.

Dobrivoje Djordjevic tha: a ka afat ligjor për ankesa?

Bajram Abazi tha: operatori ekonomik e bënë ankesen në Ministri, Ministria ka kthyer pergjigje dhe ka shpall fitues përsëri tē njejtën kompani, mandej ka bërë ankes në OSHP, pasi që e kan shqyrtuar OSHP ankesen e kan dërguar në Ministri për rishqyrtim.

Pika e katërt: Asfaltimi i rrugës në fshtin Bostan;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Zyrtarit për Sherbime Publike Bajram Abazi.

Bajram Abazi tha: nese kish pas mundësi parashtuesja e kërkeses me sqaru se për cilën rrugë bëhet fjal.

Behare Jashari tha: është një rrugë në lagjen Bostan, prej viti 2013 kemi bërë kërkesa por në asnjë kërkes nuk jan përgjigjur, rruga është afër 1 km por ne kemi kërkuar që tē asfaltohen vetem 130m, është bërë problem pasi që tē gjithë e kan rrugen e asfaltuar, vetem romët jan diskriminuar.

Bajram Abazi tha: e di se cila pjesë e rrugës është, e kemi vizituar at rrugë, çdo vit bëjm riparime tē rrugëve, nuk është e vërtet se jeni tē anashkaluar ju romtë, pasi që një pjesë e romëve e kan rrugen e asfaltuar, sikur tē kishim mundësi menjëher do ta asfalonim pasi që nuk ka shumë metra ajo rrugë.

Pika e pestë: Problemët me ujra tē zeza në fshtatin Bostan;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Zyrtarit për Sherbime Publike Bajram Abazi.

Bajram Abazi tha: kam dal në terren dhe kam bërë verifikimin se ku ka probleme me ujra tē zeza, e kam pregaditur paramasen dhe besoj se prej tē hënës do të fillojm me procedurat tenderuese.

Aleksander Pavic pasi përshtedetë tē pranishmit tha: pasi po bisedohet për kanalizimet e kam një kërkes nga një banor i fshatit Koretisht për rregullim tē kanalizimit pasi që ka problem me ujëra tē zeza.

Bajram Abazi tha: besoj se shumë shpejt do të zgjidhet ky problem.

Pika e gjashtë: tē ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: po e shfrytëzoj këtë rast pasi e kemi përfaqësuesin e UNMIK-ut pasi që u njoftu me gjendjen në të cilën jan ambulantat a keni ju mundësi që të ndihmoni në organizaten tuaj për ndonjë donacion.

Nevzad Qurroi përfaqësues i zyres së UNMIK-ut pasi përshendetë të pranishmit tha: roli ynë është monitorimi dhe raportimi i shqetësimeve, problemeve të Komuniteteve, raportet tona shkojn në këshill të sigurimit dhe i lexojn edhe Ministrit dhe Qeveria e Kosovës. Përmes raporteve tona lidhur me shqetësimet njoftohen edhe donatorët.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi ne ora 11:50



Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete